VENDIM
Nr. 143, datë 24.4.2023

MBI SHTYRJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s LIDHUR ME RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË SHA, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; nenit 14, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.4.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 999/7 prot., datë 19.4.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 3.9.2018,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 77, datë 15.3.2023, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 16.3.2023 dhe 17.3.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 25.3.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e kësaj procedure u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 122, datë 4.4.2023, vendosi të zgjasë me 20 ditë vendimmarrjen e Bordit, në lidhje me aplikimin e shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a., me qëllim plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- ERE, me shkresën nr. 999/6, datë 18.4.2023, i është drejtuar shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a., duke i kërkuar dokumentacionin e konstatuar të munguar. Në vijim shoqëria është përgjigjur, duke depozituar në ERE informacion mbi ushtrimin e aktivitetit të licencuar.
- Sa rezulton nga dokumentacioni i depozituar nga ana e shoqërisë lind nevoja për saktësime/sqarime të dokumentacionit financiar. Në mbështetje të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", dhe nenit 14, pika 3, e "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me qëllim saktësim e dokumentacionit financiar, vlerësohet e arsyeshme shtyrja me 30 ditë pune e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me rinovimin e licencë së shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen përfundimtare të Bordit të ERE-s në lidhje me rinovimin e licencës nr. 422, seria T18, të shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 3.9.2018.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR
Petrit Ahmeti